

SBASHK Arsimimi sot

Tetor, 2023

Gazeta elektronike

Takime me dy udhëheqësit më të lartë të EI-sëv Sekretari i përgjithshëm Edvards krenohet me SBASHK-un



Në kuadër të pjesëmarrjes në Konferencën e organizuar në Meksikë nga Internacionalja Botërore e Arsimit nënkryetarja e SBASHK-ut Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë zhvilluar takime të ndara me sekretarin e përgjithshëm të sindikatës së Meksikës Alfonso Cepeda Salas, me kryetarë të shumë sindikatave nga e tërë bota dhe me kryetaren e Internacionales Botërore të Arsimit Suzan Hopgood e me sekretarin e përgjithshëm David Edvards, ... (faqe 4)

Meksika mikpritëse e përfaqësuesve të Sindikatave të Arsimit nga e tërë bota
SBASHK pjesë e këtij aktiviteti të veçantë sindikal



Duke vazhduar aktivitetet ... (faqe 4)

Sindikatat e Arsimit të Evropës
u takuan në Çeki

**SBASHK – Qeveria
angazhohet për ti shuar
sindikatat**

Unioni i Sindikatave të Arsimit
(Faqe 7)

Intervistë me kryetarin
e kuvendit sindikal për
komunën e Vushtrisë, Kadri
Hyseni



Bashkërisht do të
angazhohemi në shërbim të
anëtarësisë... (faqe 3)

Një ditë me minatorët në thellësitë e tokës së Kosovës

**Mbështetje e fuqishme për kërkesat legjitime të
grevistëve**



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman... (faqe 8)

Editorial

Kushtet e punës që i duam e nuk i kemi



Në të kaluarën e afërt duke u munduar që t'i kundërviheshin kërkesave legjitime të SBASHK-ut institucionet thoshin pse këta po flasin e po bëjnë veprime sindikale vetëm për paga dhe mundoheshin t'i fshehin e heshtin kërkesat tona të bëra publike edhe për kushtet e munguara të punës. Sa e sa herë kemi bërë kërkesa publike që shkollat tona të pajisen me mjete bashkëkohore të punës në mënyrë që betejën për dije mos ta vazhdojmë vetëm me tekste shkollore e me shpuza e shkumës. Këto kërkesa Qeveria paraqitet sikur nuk i dëgjon dhe i lë punëtorët e arsimit ta vazhdojnë misionin e tyre të shenjtë për arsimimin e edukimin e brezave po me këto mjete pune.

Në shkollën e shekullit 21 duhet të ketë mjete pune për kërkesat e këtij shekulli dhe duhet që mësuesi të jetë

i mbështetur me trajnime që atij i duhen për t'ia lehtësuar angazhimet arsimore. Këto kushte mungojnë dhe nuk duket në horizont ndonjë vullnet i Qeverisë për të bërë atë që duhet. Fjalimet i kanë të zjarrta dhe ato mbesin vetëm premtime. Pjesa më e madhe e punëtorëve ta arsimit janë të përkushtuar dhe i gëzohen shumë arritjeve të nxënësve të tyre. Ata meritojnë kushte të mira pune dhe mundësi që të hapërojnë me zhvillimet dhe kërkesat e këtij shekulli. Atyre u duhen mesazhe përkrahjeje nga institucionet e jo presione e lëndime të figurës së mësuesit. Qeveria duhet ta kuptojë se investimi në arsim nuk është thjeshtë shpenzim, por investim në të ardhmen.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Intervistë me kryetarin e kuvendit sindikal për komunën e Vushtrrisë, Kadri Hyseni



Bashkërisht do të angazhohemi në shërbim të anëtarësisë

Kadri Hyseni është veprimtar sindikal që nga viti i punësimit në arsim. Me punë e përkushtim ka krijuar besim meritore te koleget dhe kolegët në Vushtrri. Ai para

pak ditësh u zgjodh me votën e lirë e të fshehtë kryetar i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Vushtrrisë, duke zëvendësuar kolegun Visar Sadiu, i cili ka kaluar në detyrë të re. Ne po përcjellim te ju lexues të nderuar intervistën që kemi zhvilluar me Kadriun.

Arsimimi sot

Kush është Kadri Hyseni?

Kadriu

Jam nga Vushtrria i lindur me: 13.10.1980. Shkollën fillore dhe të mesme i kam përfunduar në Vushtrri, Fakultetin dhe studimet master në Universitetin e Prishtinës, drejtimi: Master në Mësimdhënie në Teknologji dhe TIK. Që nga shtatori i vitit 2003 punoj si mësimdhënës i teknologjisë dhe TIK-ut në Vushtrri

Arsimimi sot

Cili është aktiviteti juaj sindikal?

Kadriu

Prej kur jam punësuar konkretisht vitit 2003 jam anëtarësuar në SBASHK dhe aktiviteti im sindikal ka qenë njëherë në shkollën ku kam punuar pastaj në kryesinë e shoqatës sindikale e pastaj kolektivi i shkollës ma besuan detyrën e kryetarit të shoqatës, po në atë kohë u mbajt edhe kuvendi zgjedhor komunal ku edhe në atë kuvend mu besua detyra e anëtarit të kryesisë. Aktivitetet kanë qenë të vazhdueshme me qëllimin e vetëm që organizata sindikale të jetë sa më e fuqishme në mbrojtjen e punëtorëve në sektorin e arsimit.

Arsimimi sot

Si ndiheni si udhëheqës sindikal për Vushtrri?

Kadriu

Jam në fillim të mandatit si udhëheqës sindikal në Vushtrri dhe kjo është përgjegjësi shumë e madhe. I falënderoj kryetarët e shoqatave sindikale për besimin e dhënë është ndjenjë e mirë por shumë sfiduese në këto rrethana por me ndihmën e kolegëve do konsolidohemi edhe më mirë në realizimin e qëllimeve tona.

Arsimimi sot

Kadriu si trajner. Si ndiheni?

Kadriu

Kjo është pjesa më e veçantë e imja sepse ndihem mirë kur ligjëroj në pjesë të ndryshme të Kosovës dhe kam bashkëbiseda me shumë mësimdhënës. Nga këto bashkëbiseda mësojë shumë gjëra të reja nga ta në aspektin e mësimdhënies-nxënies. Ndhem shumë mirë gjatë gjithë këtij aktiviteti sindikal.

Arsimimi sot

Cili është arsimi sot në Kosovë?

Kadriu

Mendoj se arsimi Kosovarë sot ka nevojë për një qasje më serioze nga qeveria konkretisht nga Ministria e Arsimit, si në aspektin infrastrukturor (pajisjen e shkollave me pajisje teknologjike, laboratore, kabinet) etj, po ashtu edhe në rishikimin e teksteve mësimore të cilat mendoj se janë të ngarkuara.

Arsimimi sot

Mesazhi juaj për koleget dhe kolegët kudo janë.

Kadriu

Të jemi të bashkuar të gjithë në SBASHK-ë që kjo organizatë të jetë sa më e sa më e fuqishme në mënyrë që sfidat gjatë rrugëtimit t'i kalojmë sa më lehtë.

Gjatë muajit

Takime me dy udhëheqësit më të lartë të EI-së **Sekretari i përgjithshëm Edvards krenohet me SBASHK-un**

Në kuadër të pjesëmarrjes në Konferencën e organizuar në Meksikë nga Internacionalja Botërore e Arsimit nënkryetarja e SBASHK-ut Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë zhvilluar takime të ndara me sekretarin e përgjithshëm të sindikatës së Meksikës Alfonso Cepeda Salas, me kryetarë të shumë sindikatave nga e tërë bota dhe me kryetaren e Internacionales Botërore të Arsimit Suzan Hopgood e me sekretarin e përgjithshëm David Edvards.

Sekretari i përgjithshëm Edvards në këtë takim ka thënë se mburret me gjithë angazhimet e SBASHK-ut dhe ka shprehur shqetësimin për bllokimin e dialogut social me fajin e Qeverisë së Kosovës. Ai ka shprehur gatishmërinë që të vazhdojë me angazhimet në mbështetje të SBASHK-ut dhe se do të dërgojë letra institucioneve duke kërkuar qasje pozitive ndaj dialogut dhe komunikimit me SBASHK-un dhe sindikatat tjera. Edhe kryetarja e EI-së Hopgood ka shprehur respekt për angazhimet e SBASHK-ut dhe ka përsëritur mbështetjen e fuqishme të EI-së për gjithë angazhimet dhe përkushtimin e sindikatës sonë në shërbim të anëtarësisë.

Ajo është shprehur e gatshme të vazhdojë me angazhimet dhe me përpjekjet që të zhvillohet dialog i mirëfilltë i institucioneve të Kosovës me SBASHK-un, dialog ky i munguar me fajin e Qeverisë.



Meksika mikpritëse e përfaqësuesve të Sindikatave të Arsimit nga e tërë bota **SBASHK pjesë e këtij aktiviteti të veçantë sindikal**

Duke vazhduar aktivitetet e përbashkëta sindikale me përfaqësues të 32 milionë anëtarëve nga e tërë bota, Internacionalja Botërore e Arsimit ka organizuar në Meksikë Konferencën e 12 tematike.



Në këtë ngjarje të veçantë sindikale SBASHK-u u përfaqësua nga nënkryetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri. Në punimet e kësaj Konference, krahas udhëheqësve të EI-së dhe përfaqësuesve të sindikatave të arsimit nga e tërë bota, kanë marrë pjesë edhe presidenti i Meksikës, Andres Manuel Lopez Obrador dhe zyrtarë të artë nga qeveria meksikane.





Në hapje të Konferencës sekretari i përgjithshëm i Sindikatës së Arsimit të Meksikës, Alfonso Cepeda Salas ka përshëndetur pjesëmarrësit e duke falënderuar në emër të tyre presidentin e Meksikës Andres Manuel Lopez Obrador, që bashkë me zyrtarë të tjerë të lartë u bë pjesë e këtij aktiviteti të veçantë sindikal.

Presidenti Obrador duke iu dëshiruar mirëseardhje pjesëmarrësve ka deklaruar se ka bashkëpunim të shkëlqyer me sindikatën e arsimit të Meksikës dhe se bashkërisht angazhohen në shërbim të arsimit dhe të zgjidhjes së kërkesave të punëtorëve të arsimit. Pas kësaj

Kuvend zgjedhor i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar në Vushtri **Kryetar i ri u zgjodh Kadri Hyseni**

Para fillimit të punimeve të këtij Kuvendi zgjedhor kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala, koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, zyrtarin ligjor Blendor Shatri, kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Vushtrrinë Visar Sadriu dhe anëtarin e kryesisë Kadri Hyseni u takuan me kryetarin e komunës z. Ferit Idrizi.



Kryetari i SBASHK-ut ka falënderuar kryetarin Idrizi për pritjen dhe respektin për ta përgëzuar për gjithë angazhimet në shërbim të qytetarëve të kësaj komune dhe për përkushtimin e vazhdueshëm në përmirësimin e kushteve të punës në institucionet arsimore dhe për bashkëpunimin korrekt me sindikatën tonë. Kryetari i Komunës së

pjesëmarrësve me fjalë rasti u janë drejtuar edhe kryetarja e Internacionales Botërore të Arsimit Suzan Hopgood dhe sekretari i përgjithshëm David Edvards. Diskutuesit në këtë Konferencë kanë treguar për sfidat e shumta me të cilat po përballlet arsimit në shtetet e tyre duke bërë thirrje të institucionet që ta mbështesin arsimin dhe të garantojnë financim të mjaftueshëm për këtë sektor, që i shërben të mirës së përgjithshme.



Vushtrisë Ferit Idrizi duke përshëndetur mysafirët ka shprehur respekt për angazhimet e SBASHK-ut si zë i punëtorëve në sektorin e arsimit e pastaj ka treguar për angazhimet në shërbim të një arsimit edhe më cilësor.



Kryetari Idrizi është shprehur se me kryetarin Sadriu dhe kryesinë e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar në Vushtri kanë pasur vazhdimisht komunikim dhe bashkëpunim korrekt duke u angazhuar bashkërisht në shërbim të arsimit dhe të punësuarve në këtë sektor. Lidhur me dialogun korrekt që po zhvillohet nga SBASHK dhe komunat e Kosovës ka folur nënkryetarja Vjollca



Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri duke u shprehur të sigurt se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen me përkushtimin e përbashkët e në shërbim të arsimit dhe në përpjekjet brenda mundësive për realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë. Pas kësaj përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë marrë pjesë në Kuvendin zgjedhor, që është mbajtur në sallën e takimeve të Asamblesë Komunale.



Në hapje të këtij Kuvendi kryetari Visar Sadriu ka përshëndetur pjesëmarrësit e pastaj prezantuar raportin e punës dhe atë financiar. Anëtarët e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Vushtrrisë kanë aprovuar të dy këto raporte. Pas kësaj Sadriu ka falënderuar koleget e kolegët në Vushtri për bashkëpunimin dhe angazhimet e përbashkëta në shërbim të anëtarësisë duke shtuar se zgjedhja për drejtor shkolle dhe angazhimet e shumta që po kërkon ajo detyrë, ka bërë që në komunikim me kryetarin e SBASHK-ut dhe stafin qendror të arrijnë në përfundim për mbajtjen e Kuvendit zgjedhor. Në vazhdim të takimit kryetari i SBASHK-ut ka përshëndetur pjesëmarrësit duke i përgëzuar për angazhimet në misionin e shenjtë për edukimin e brezave e pastaj ka treguar për angazhimet, por dhe për sfidat me të cilat po përballën sindikatat në Kosovë.



Në pjesën e dytë të këtij Kuvendi zgjedhor është formuar Komisioni zgjedhor e pastaj pjesëmarrësit kanë dhënë tri propozime për kryetarin e ri.



Me votën e fshehtë nga pjesëmarrësit e Kuvendit kryetar i ri u zgjodh Kadri Hyseni. Ai duke u falënderuar për besimin e dhënë u zotua se bashkë me kryesinë dhe me veprimtarët sindikalë do të angazhohet për shtimin e numrit të anëtarëve dhe për prezantimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë duke u angazhuar maksimalisht për realizimin e tyre.



Me rastin e kësaj vizite në Vushtri kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, nënkryetarja Vjollca Shala, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe zyrtari ligjor Blendor Shatri kanë vizituar Shoqatën e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së për këtë komunë.

Ata janë pritur nga Gëzim Zuçaku, kryetar i kësaj Shoqate dhe vëlla i dëshmorit të kombit Blerim Zuçaku. Kryetari Jasharaj është shprehur se punëtorët e arsimit ruajnë dhe lartësojnë kujtimin për bijtë e bijat më të mira të atdheut që me gjakun e tyre kanë shkruar faqe të ndritura të historisë dhe i kanë sjellë lirinë atdheut. Kryetari Gëzim Zuçaku ka falënderuar përfaqësuesit e SBASHK-ut dhe bashkë me ta ka lartësuar kujtimin për dëshmorët e kombit.



Sindikatat e Arsimit të Evropës u takuan në Çeki SBASHK – Qeveria angazhohet për ti shuar sindikatat

Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE), që numëron 11 milionë anëtarë, duke parë se shumë nga sindikatat e arsimit në vende të Evropës po përballen me sfida të shumta të kohës dhe me tendencën e qeverive për t'i ikur dialogut social dhe zgjedhjes së kërkesave legjitime të anëtarësisë, ka organizuar në kryeqytetin e Çekisë një takim treditor për të debatuar për gjithë çështjet aktuale në arsim dhe për të marrë vendime për angazhime të përbashkëta në përballje me sfidat që janë të shumta.



Kryetari i Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, Larry Flanagan dhe drejtorja e përgjithshme Susan Flocken në fjalët e tyre hyrëse kanë përshëndetur përfaqësuesit e sindikatave pjesëmarrëse në këtë aktivitet të rëndësishëm duke prezantuar edhe agjendën e ngjeshur të aktiviteteve për tri ditë me radhë. Flanagan dhe Flocken janë shprehur se sindikatat, por edhe arsimimi në tërësi në gjithë shtetet e Evropës, po përballen me shumë sfida dhe se hetohet tendencë e shumë qeverive për t'i ikur dialogut me sindikatat.



Në këtë ngjarje të rëndësishme sindikale SBASHK-un e kanë përfaqësuar nënkryetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri. Nënkryetarja Shala duke përcjellë mesazhin e kryetarit Jasharaj dhe të gjithë anëtarësisë ka deklaruar se SBASHK

shpreh respekt meritore për kryetarin Flanagan, drejtoreshen Flocken, por edhe për gjithë kolegët në Unionin e Sindikatave të Arsimit të Evropës, të cilët në vazhdimësi janë angazhuar dhe kanë mbështetur fuqishëm SBASHK-un në gjithë angazhimet për realizimin e kërkesave të anëtarësisë dhe në gjithë momentet e përballjes me sfidat e shumta.



Nënkryetarja e SBASHK-it ka përmendur para sindikalistëve në Pragë pjesë nga letra dërguar kryetarit Flanagan dhe drejtoreshes Flocken për situatën plot sfida nëpër të cilën po kalon SBASHK-u duke përsëritur se Qeveria në Kosovë nuk e do dialogun social e madje edhe ka bërë e vazhdon të bëjë shumë goditje e angazhime për të zbeh aktivitetet sindikale e madje edhe për t'i shuar në tërësi sindikatat e veçmas SBASHK-un, që është sindikata më e fuqishme dhe më e zëshme në Kosovë. Paraqitja e nënkryetares së SBASHK-it është përcjellë me interesim të veçantë nga pjesëmarrësit.



Kryetari i Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, Larry Flanagan duke u kyçur në bashkëbisedë është shprehur i shqetësuar pse Qeveria në Kosovë ka qasje të gabuar ndaj sindikatave dhe ndaj dialogut social, i cili duhet zhvilluar në përpjekje të përbashkëta për zgjedhjen e çështjeve të ngritura. SBASHK-u kishte dhe ka mbështetjen e fuqishme të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës. Pjesëmarrësit e këtij takimi të rëndësishëm kanë debatuar për tri ditë me radhë e do të nxjerrin përfundime të përbashkëta për aktivitetet sindikale që do të zhvillohen nga sindikatat anëtare.

Një ditë me minatorët në thellësitë e tokës së Kosovës **Mbështetjet e fuqishme për kërkesat legjitime të grevistëve**

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me kryetarin e BSPK-së Atdhe Hykolli, nënkryetarin Skënder Lushtaku dhe kryetarin e Sindikatës së Shërbyesve Civil Ali Gashi të premten e 27 tetorit kanë vizituar minatorët grevistë. Ata fillimisht janë takuar në zyrën e sindikatës së minatorëve me kryetarin e Sindikatës së Pavarur të Minatorëve të Trepçës Ibrahim Januzi dhe me anëtarë të kryesisë. Kryetari Januzi ka informuar mysafirët për gjendjen tepër të rëndë të një numri të madh të minatorëve që po vazhdojnë grevën në galerinë e nëntokës në thellësi prej 800 metra.



Jasharaj, Gashi e Lushtaku pastaj të veshur si minatorë janë gjendur në thellësitë e tokës për t'u takuar me minatorët grevistë. Kryetari Jasharaj është pritur me duartrokitje. Ai i emocionuar u ka shprehur mbështetjen e punëtorëve të arsimit, që nga çerdhet e deri në universitete.



Qendra Amerikane e Solidaritetit me SBASHK-un vazhdojnë aktivitetet nëpër komuna **Ide konkrete të angazhimit për forcimin e zërit sindikal**

Në kuadër të angazhimit të përbashkët për forcimin e zërit sindikal Qendra e Amerikane e Solidaritetit dhe SBASHK-u vazhdojnë me organizimin e punëtorëve me veprimtarë sindikalë nëpër komunat e Kosovës. Ky aktivitet u organizua me sukses në Prizren me veprimtarë sindikalë nga kjo komunë dhe nga Suhareka, Dragashi e Mamusha, në Ferizaj me veprimtarë sindikalë nga kjo komunë dhe nga Kaçaniku, Shtime, Hani i Elezit dhe

Ai ka theksuar se minatorët ishin dhe mbesin krenari e atdheut dhe simbol i qëndresës. Kryetari Jasharaj duke kritikuar institucionet, që nuk po dëgjojnë zërin e minatorëve është shprehur se djersa e minatorëve do të jetë mallkim për gjithë ata që janë të thirrur të kujdesen për kushtet e punës dhe realizimin e kërkesave legjitime të këtyre njerëzve që rrezikojnë shëndetin dhe jetën për të kryer detyrat prej minatorit në thellësitë plot rreziqe.



Edhe Gashi e Lushtaku kanë shprehur përkrahjen e sindikatës që përfaqësojnë për minatorët grevistë. Teksa ata po qëndronin në bashkëbisedë me grevistët nga afër vërenin fytyrat e stërlodhura dhe angazhimet që të nxjerrin jashtë nga galeria e nëntokës, grevistë që ishin tepër keq me shëndetin.

Shtërpeca, në Pejë me veprimtarë sindikalë nga kjo komunë dhe nga Klina, Istogu, Deçani e Juniku e po ashtu në Gjakovë me veprimtarë sindikalë nga kjo komunë dhe nga Rahoveci e Malisheva.

Pjesë e këtij aktiviteti në Prizren e Ferizaj ishte edhe drejtori i Qendrës Amerikane të Solidaritetit, Steven McCloud, i cili duke përshëndetur pjesëmarrësit ka treguar për angazhimet dhe aktivitetet e kësaj qendre me



seli në Tiranë që është e përkushtuar të mbështesë sindikatat në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni të Veriut.



Ai pastaj ka lavdëruar angazhimet e SBASHK-ut për përfaqësimin me dinjitet të kërkesave legjitime të anëtarësisë dhe mbrojtjen e vazhdueshme të tyre. Ai pastaj ka dhënë shembuj të angazhimeve të sindikatave kudo në botë e duke përmendur raste konkrete nga veprimtaritë sindikale në SHBA. Z.Steven ka deklaruar se kudo në botë sindikatat po përballën me sfida të shumta dhe prandaj kërkohet unitet i anëtarësisë dhe solidaritetet e bashkëpunim mes sindikatave nga të gjitha vendet e botës.



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj në Prizren dhe në Ferizaj ka falënderuar Drejtorin McCloud dhe anëtarët e stafit Bruna e Kejsi për gjithë përkushtimin dhe angazhimin për të shtuar bashkëpunimin mes sindikatave dhe për të ndihmuar ato në përballjen me sfidat e shumta të kohës. Jasharaj ka kujtuar në fjalën përshëndetëse edhe bashkëpunimin nëpër vite e dekada me Sindikatën

e Mësuesve të Amerikës, por edhe me sindikatat nga Holanda, Sllovenia, Gjermania dhe nga shumë vende të tjera në Evropë e tërë botën.



Në tryezat e punës në Prizren e Ferizaj nënkryetarja e SHBASHK-ut, Vjollca Shala ka folur për strukturën dhe programet e SBASHK-ut, ndërsa zyrtarja e Qendrës Amerikane të Solidaritetit Bruna Hylviu ka dhënë shembuj konkret të organizimit sindikal në vende të ndryshme të botës. Lidhur me strategjitë për rekrutimin e anëtarëve të rinj koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri ka zhvilluar aktivitetet përmbajtjesor në grupe.



Janë përcjell me interesim nga pjesëmarrësit edhe prezantimi i drejtorit McCloud “Organizimi i sindikatave amerikane dhe strategjitë për rekrutimin e anëtarëve të rinj dhe shpалosja nga kryetari Jasharaj e historikut të SBASHK-ut në gjithë vitet e dekadat e angazhimeve në shërbim të arsimit dhe të anëtarësisë”.



Punëtorja ka përfunduar në mesditën e të shtunës në Prizren, kurse në Ferizaj ky aktivitet përfundon të dielën e tetë tetorit me detyrat konkrete që do të kenë pjesëmarrësit në angazhimet në shoqatat sindikale të komunave të tyre.

Duke vazhduar me bashkëpunimin Qendra Amerikane e Solidaritetit me seli në Tiranë dhe SBASHK-u kanë mbajtur punëtori me veprimtarët sindikalë edhe në Pejë e në Gjakovë. Në punëtorinë e organizuar në Pejë pjesëmarrësit i ka përshëndetur zyrtarja Bruna Hylviu duke treguar se drejtori Steven është i angazhuar në një aktivitet tjetër sindikal. Ajo pastaj ka treguar për aktivitetet e Qendrës në shërbim të forcimit të zërit sindikal për të përgëzuar SBASHK-un për gjithë angazhimet dhe arritjet në shërbim të anëtarësisë e pastaj u ka sqaruar pjesëmarrësve se cilat do të jenë temat kyçe që do të shpalosën në këtë aktivitet. Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka falënderuar Qendrën Amerikane të Solidaritetit për angazhimet dhe për përkrahjen ndaj sindikatave të arsimit të Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni të Veriut.



Pas kësaj nënkryetarja Vjollca Shala ka prezantuar strukturën organizative të SBASHK-ut, kurse zyrtarja Bruna Hylviu ka treguar për përvojat e organizimit sindikal në shtete të ndryshme duke ofruar fakte të shumta pse duhet një i punësuar të jetë anëtar i sindikatës. Koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri ka informuar të pranishmit për numrin e të regjistruarve në e Kosova sipas komunave e pastaj ka dhënë sqarime rreth regjistrimit duke e prezantuar edhe një video të përgatitur nga stafi qendror i SBASHK-ut, e cila ofron shumë

informacione dhe ndihmon në regjistrimin e suksesshëm në këtë platformë.



Në ditën e dytë të punëtorisë në Pejë kryetari Jasharaj ka kujtuar disa nga momentet e veçanta të angazhimit të SBASHK-ut që nga themelimi e deri tani për të filluar me rolin e sindikatës sonë në ruajtjen dhe organizimin e arsimit shqip në vitet e okupimit e për të vazhduar për aktivitetet e shumta e përmbytjesore në gjithë vitet e lirisë. Pjesëmarrësit e këtij aktiviteti pastaj të udhëhequr nga nënkryetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë punuar në grupe duke ofruar ide konkrete të angazhimeve sindikale. Atmosferë përkushtimi e angazhimi ishte edhe në punëtorinë e organizuar në Gjakovë. Këtu veprimtarët sindikalë nga kjo komunë dhe nga Rahoveci e Malisheva kanë përcjellë me kujdes prezantimet e përfaqësueses së Qendrës Amerikane të Solidaritetit Bruna Hylviut dhe të kryetarit Rrahman Jasharaj, nënkryetares Vjollca Shala dhe koordinatorit për organizim të brendshëm Ymer Ymeri e pastaj duke punuar në grupe kanë dhënë ide e propozime konkrete për aktivitetin sindikal në të ardhmen. Në këto aktivitete sindikale kanë marrë pjesë edhe kryetarët e nivelit komunal sindikal Reshit Kushaj, Vloran Krasniqi, Isuf Lajçi, Arif Elezaj, Burim Avdijaj, Zenun Nimani, Veli Morina e Skënder Gashi.

SBASHK vazhdon marrëveshjen e mirëkuptimit me Banjën “Nëna Naile” në Kllokot Zbritje çmimesh të shërbimeve për anëtarët e sindikatës sonë



Përfaqësuesit e SBASHK-ut Blerim Mehmeti, Kemajl Bislimi dhe Ismet Mehmeti kanë vizituar ambientet e Spitalit Special me Terapi Fizikale dhe Rehabilitim Banja Nëna Nailie në Kllokot dhe kanë nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me përfaqësuesin e këtij institucioni Ylli Morina.

Kjo marrëveshje mirëkuptimi ka bërë që të vazhdojë bashkëpunimi i SBASHK-ut me këtë institucion të njohur shëndetësor për terapi fizikele dhe rehabilitim. Në marrëveshje thuhet se udhëheqja e Spitalit Special me Terapi Fizikale dhe Rehabilitim Banja Nëna Naile në Kllokot, gjegjësisht drejtori i përgjithshëm Daradan Novosellla ka aprovuar kërkesën e përfaqësuesve të SBASHK-ut dhe me

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

këtë marrëveshje të nënshkruar anëtarëve të SBASHK-ut u mundësohet në mënyrë të organizuar, apo individualisht duke dëshmuar se janë anëtarë të kësaj sindikate të marrin shërbimet standarde në këtë banjë me zbritjen sikur në marrëveshjen e kaluar.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë falënderuar stafin udhëheqës dhe të punësuarit në këtë institucion të respektuar shëndetësor për respektin e treguar për punëtorët e arsimit duke theksuar se edhe në të kaluarën shumë nga anëtarët e SBASHK kanë kaluar disa ditë pushimi e rehabilitimi në

Banja Nëna Naile dhe janë shprehur me respekt për pritjen dhe gjithë angazhimet e stafit këtu. Ata kanë përcjellë në këtë takim me sekretarin e Spitalit Special me Terapi Fizikale dhe Rehabilitim, Ylli Morina edhe falënderimet e kryetarit Jasharaj dhe të stafit qendor të SBASHK-ut duke qenë të sigurt se kjo marrëveshje do të jetë një mundësi e mirë për anëtarët e sindikatës sonë nga e tërë Kosova që të kalojnë disa ditë në këtë institucion të respektuar duke gëzuar gjithë shërbimet standarde , por me një çmim me zbritje për ta.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture